

## URATA TË NDRYSHME

### URATA E PALLMAVE

*Kjo Urate kendohet te Dielen e Luleve, kur u perndahen besnikeve pallmat perpara ose pas Meshes.*

O Zot, o Perendia yne, qe u-prite ne Jerusalém me buje dhe me brohorí, me degë, me lule, me dafina e me pallma; ti, o Kryezót, bekona né, qe po kujtojme keté dite te shenuar, dyke mbajtur ne dore pallma dhe degë, dhe vleresona te arrijme shendoshe Ngjalljen e Zotit tone Jesú Krisht, me te cilin je i bekuar, bashke me Shpirtin e tere-shenjte dhe te mire dhe jeteberes, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E SG ENJTES SG MADHE

*Kjo Urate e Shen Joán Gojartit kendohet te Enjten e*

*Madhe perpara besnikeve, qe vijne te kungohen ne funt te Meshes.*

Vellezer dhe motra, qe jini mbledhur per te kunguar Misteret e shenjta te Krishtit, degjoni ketó keshilla, qe ju jap une, sherbetori juaj i per-unjur dhe i pavyer. Se ketó fjale nuke jua thom une, po hiri i Shpirtit Shenjt; se nuke ju flas nga vetja ime, po sipas porrosive te Apostujve dhe te Aterve te shenjte. Perandáj pra, ju keshillónj te gjithë sa jini ketú, burra e gra, te medhénj e te vegjel: Asnjé prej jush nuke duhet te kungonje para se te nunerohet, e te pendohet per te gjitha mekatat, qe ka bere. Se kungata eshte drite, shenjterím dhe paqesím per atá, qe kungohen me bese dhe me frike Perendie. Po kungata eshte zjarr, qe pervelón mekataret e papenduar. Pra, vellezer dhe motra, kini mendjen, dhe mos kungoni te papenduar, te pagatitur dhe te pavyer, se ahëre shtoni nje mekát te ri mi mekatat e vjetra, dhe jo vetem nuke kini nonjé fitím, po do te merrni nje dením te rende ne keté bote dhe ne tjetren perpara Gjykatores se Krishtit, i cili eshte Perendia dhe Mbreti yne. Dhe atí i ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E PASHKES

*Kjo Urate e Shen Joán Gojartit kendohet dite e Pashkes pas Meshes.*

Cilidó besemire dhe hyjdashes le ta gezonje ke-

té panair te mire dhe gazmór. Cilidó sherbetór mirenjohes le te hynje i gezuar ne gazin e te Zotit. Aý, qe u-mundua me kreshme, le ta marre taní çpagimin. Aý, qe punój qe prej ores se pare, le ta marre sot rogen e plotts. Aý, qe ardhi pas se trectes, le te kremteronje me gjithë zemer. Aý, qe arriu pas se gjashtes, le te mos dyshonje asfare, se nuke pesón asnjé dem. Aý, qe vonój gjer me te nenten, le te afrohet pa hezituat fare. Dhe aý, qe arriu vetem me te njembbedhjetten, le te mos trembet nga vonimi. Se Zoti i zemerdhempshur e pret te funtmin si edhe te parin, dhe e çloth até te ores se njembbedhjette si até, qe punój qe prej ores se pare. Edhe te funtmin e meshirón, edhe te parin e sherón; edhe ketí i jep, edhe atí i fal; edhe punct i pret, edhe mendimin e pelqén; edhe vepren e nderón, edhe qellimin e levdón. Hyni, pra, te gjithë, ne gazin e Zotit tone; edhe te pare edhe te dyte, merreni rogen. Te pasur dhe te varfer, vallezo-ni me njerjatin; te perkorme dhe te ngathet, kremtójeni keté dite; sa kreshmuat dhe sa nuke kreshmuat, defreni sot. Tryeza eshte plot, hani qe te gjithë. Gjella esht e shume, asnjé le te mos dale i uret. Te gjithë, gezójeni dasmen e beses; te gjithë, gezójeni pasurín' e miresise. Asnjé le te mos vajtonje per varferí, se u-çfaq Mbreteria e perbashkme. Asnjé le te mos qanje per faje, se ndjesa lindi nga varri. Asnjé le te mos kete frike nga vdekja, se na çlirój vdekja e Shpetimtarit. E shojti kur permbahej prej asáj. E plaçkiti Ferrin

aý, qe zbriti ne Ferr. E hidherój, kur ngjerój mishin e tij. Dhe keté e pareshikój Isaia, dhe thirri: Ferri u-hidherua, kur te hasi poshte. U-hidherua, se u-dermua. U-hidherua, se u-genjye. U-hidherua, se u-vra. U-hidherua, se u-rrezua. U-hidherua, se u-burgós. Priste nje njerí, dhe gjeti Perendine. Priste dhenc, dhe hasi qellin. Ku eshte gjembi yt, o vdekje? Ku eshte mburrja jote, o Ferr? U-ngjall Krishti, dhe ti u-hodhe poshte. U-ngjall Krishti, dhe u-permbysne demonet. U-ngjall Krishti, dhe gezohen Engjejte. U-ngjall Krishti, dhe jeta qytetcrohet. U-ngjall Krishti, dhe asnjé i vdekur nuke mbeti ne varr. Se pas Krishtit u-ngjallne te gjithë te vdëkurit. E atí eshte lavdia dhe fuqia ne jetet e jéteve. Amín.

## URATA E KONVERTEVE

*Kur nje Konvért hidhet nga nje fe tjater ne fene Orthodoxe, Pifti kerkón prej tij disa deklarata me pyetjet edhe pergjigjet, qe pasojne. Sherbesa nis pas menyres se zakonte: Pifti bekón, edhe thote Trishenjtin:*

**PRIFTI:** I bekuar eshte Perendia yne, gjithënjé, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

**KORI:** Amín.

**KENDONJESI:** Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

Triní e tereshenjte, meshirona; o Zot, hiresoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona;

o i Shenjte, veshetroji, dhe sheroji semundjet tona per emrin tent. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati ynë, qe je ne qell, u-shenjtcroftc emri yt; arthtc Mbreteria jote; u-befte deshira jote si ne qell edhe mi dhé; buken tone te perdítime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtóreve tane; edhe mos na shtjer ne ngasje, po shpctona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja eshte Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj Prifti e kryqesón Konvertin, dhe e pyét:*

PRIFTI: A heq dorë nga besimet e fesc, qe ke patur gjer sot?

KONVERTI: Pó, o At' i nderuar.

PRIFTI: A bashkohesh me Kishen Orthodokse?

KONVERTI: Pó, o At' i nderuar.

PRIFTI: A i besón doktrinát e Kishes Orthodokse?

KONVERTI: Pó, o At' i nderuar.

*Dhe menjehere Konverti thote Simbolin e Beses:*

KONVERTI: Besónj me nje Perendí, Atin e terefuqishim, krijetarin e qellit e te dheut e te gjithc te dúkurave dhe te padúkurave. Dhe me nje Zot Jesús Krisht, te vétemin Bir te Perendise, qe lindi prej Atit perpara gjithc jéteve. Drite prej Drite, Perendí te vertete prej Perendie te vertete, qe lindi,

dhe nuk u-be, te bashkeqenshim me Atin, me anen e te cilit u-bene te gjitha. Qe per né njérezit edhe per shpctimin tone zbriti prej qellit, edhe u-misherua prej Shpirtit Shenjt edhe Virgjereshes Marí, dhe u-be njerí. Qe u-kryqesua per né me kohen e Pontit Pilát, edhe vojti, dhe u-varrós. Dhe u-ngjall me te teten dite pas Shkrónjave. Dhe u-ngjit ne qell, dhe ndenji me te djathten e Atit, edhe do te vinje prapc me lavdí te gjykonje te gjallet e te vdékurit, edhe Mbretérí' e tij do mos ketc mbarím. Dhe me Shpirtin Shenjt, Zotin e jetebéresin, qe dergohet prej Atit, qe adhurohet, e lavdcrohet me Atin e me Birin, qe foli me anen e Proféteve. Me nje Kishc te Shenjte, te Pergjitheshme dhe Apostollore. Refénj nje Pagezím per ndjesen e mekátave. Pres ngjalljen e te vdékurve dhe jeten e botes qe vjen. Amín.

*Pastáj Prifti e kryqesón Konvertin, edhe i kendón keté Urate:*

O Perendí meshireplót, qe desherón shpctimin edhe ndriçimin e gjithc njéresve; ti, o Kryezót, prit-e shcrbetorin tent (*aksh*), qe bashkohet me Kishen e shenjtc Orthodoxe, dhe vleresoje per Misteret e shenjta te Zotit tone Jesús Krisht, me te cilin je i bekuar, bashke me Shpirtin e tere-shenjtc dhe te mire dhe jeteberes, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

*Pastáj Prifti e pagezón, e mirós, dhe e kungón Konvertin sipas zakonit.*

## URATA E RENEGATËVE TË PENDUAR

*Kjo Urate kendohet per atá, qe jane hequr nga Kisha Orthodoxe, po pastáj jane penduar, dhe kthehen perseri ne vathen.*

O Perendí meshireplót, qe nuke desherón vdekjen e mekatárëve, po shpëtimin dhe kthimin e tyre; ti, o Kryezót, prit-e sherbetorin tent (*aqsh*), qe kthehet i penduar ne Kishen tende si Biri Prodík, fal-i te gjitha mekatat, edhe vleresoje te dale faqebardhe perpara Gjykatores sate. Se ti je Perendí meshireplót, edhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

*I penduari, pasi merr keté Urate, behet perseri anetar i rëgullte i Kishes Orthodoxe, dhe nuke pagezohet as mirosot perseri, po vetem kungohet sipas zakonit.*

## URATA E USHTERISE A FLOTËS

O Zot, o Perendia yne, qe e çlirove gjindjen e Hebrenjve nga zgjedha e huaj; ti, o Kryezót, shtjer syrin nga qelli mi udhëheqësit tane, tregoj udden me nje kollone prej drite, falu vitoren kunder gjithë armiqve, dhe shiguroje paqen dhe qetesine per pópullin tone. Se ti je Mbreti i paqes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

## URATA E UDHËTIMIT A LUNDRËZIMIT

O Zot, udha jone e vërtetë dhe e gjalle, qe udhë-

tove dhe lundrezove bashke me Apostujte, ti shoqeroje sherbetorin tent (*aqsh*), rúaje nene hien e fléteve te tua, shpëtoje nga te gjithë reziket, edhe ktheje prape te shendoshe prane te dáshurve te tij. Se ti je Perendí meshireplót, edhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

## URATA E ADOPTIMIT

O Zot meshireplót, qe me anen e Birit te dashur, Zotit tone Jesú Krisht, na quájte bij te Perendise, dhe na adoptove me anen e Shpirtit Shenjt; ti, o Mbret njeridashes, shtjer syrin mi sherbetoret e tu (*aqsh*), edhe beji at' e bir si prej natyre; bashkoji me bekimin tent; shiguroji me dashurine tende; dhe beji trashëgimtare te Mbretërisë sate. Se ty te ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

*Pas Urates, Pifti e merr djalín a çupen e adoptuar dhe ia dorezón atit nga Dera e Bukur e Alltarit. I adoptuari bie me gjunje perpara atit, edhe ky i ve doren mi koke dhe thote:*

ATI: Ti je sot im-bir (*a ime-bije*), une te kam lindur sot.

*Pastáj e ngre, dhe pershendoshen. Pifti i bekón, dhe ben Perleshimin.*

## URATA E PAJTIMIT

Te perhirojme, o Kryezót njeridashes, o Mbret

i jéteve, qe largove armiçesine dhe solle paçen ne mes te sherbetóreve te tu (*aksh*); ti pra, o Kryezót, fal-u dashurine, dhe shiguroje lidhjen e tyre me bekimet e tua prej qellit. Se ti je Mbreti i paçes, edhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E FEMIJEVE TE SHKOLLES

O Perendí meshireplót e njeridashes, qe i ke dhene mesime pópullit ne témpullin e Jerusalemit; ti, o Kryezót, hap-i zemrat edhe shpirtet edhe mendjet e sherbetóreve te tu, qe te kupetojne porrosít' e tua, dhe te mbarojne deshiren tende gjithë ditet e jetes se tyre. Se ti je permiaçyesi i shpírteve dhe i trúpeve tona, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E SEMUNDJEVE

O Kryezót i terefuaçisim, mjeku i shpírteve dhe i trúpeve tona, veshtroje sherbetorin tent (*aksh*), sheroje nga semundja prej se ciles vuan, edhe ngrer-e nga shtrati, ne te cilen eshte shtrire. Largó prej tij çdo fryme prej lengate, çdo plage, çdo dhembje, çdo vrushkull e çdo ethe; dhe neqóftese ka bere nonjë mekát, fal-e pas njeridashjes sate; dhe shpctoje me anen e Zotit edhe Perendise dhe Shpëtimtarit tone Jesú Krisht, me te cilin je i bekuar, bashke me Shpirtin e tereshenjte dhe te

mire dhe jeteberes, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E AGONISE

*Kjo Urate kendohet, kur i semuri jep shpirt.*

O Zot i terefuaçisim, qe deshëron shpëtimin e gjithë njéresve; te lútemi, çliroje shpirtin e sherbetorit tent (*aksh*) nga çdo mekát e nga çdo mallkím; dhe urdheró qe shpirti i tij te gjenje prehjen ne tendat e Shenjtóreve; se ti je çlirimi i te burgósurve, ngritja e te permbyçurve dhe shpresa e te deshperúarrve, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E NDJESËS

*Kjo Urate kendohet pas vdekjes prej Peshkopit perpara Tryezes se Blates, pastáj kendohet perseri me ze te larte dhe me gjunje ne Hyrjen e Madhe perpara se te shpíren Dhuratat e Shenjta brenda ne Shenjteroren. Ne mos paste Peshkóp, munt te thuhet prej Konfesorit.*

O Zot, qe e ke bere njerine pas kores edhe shembellsise sate; kij meshire per sherbetorin e jete-nderruar (*aksh*); dhe neqóftese eshte mallkuar prej atit, a prej nenes, a prej vetes se tij; a neqóftese eshte çkishëruar prej nonjë kleriku a Kryepriifti, dhe nuk eshte kujdesur te marre ndjese; ti, o Kryezót, e ndje me anen time; edhe trupin e tij tret-e ner elementat, prej te cilave eshte perbere, dhe shpirtin e tij preh-e ne tendat e Shenjtóreve;

se ti, o Zot, u ke dhenc Apostujve, dhe neve me a-nen e tyre, fuqine ti falim mekatat; pra, qofte i ndjere nga te gjitha mekatat e shpirtit e te trupit ne keté jetë dhe ne jeten e pritme, me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve. Amín.

### LITANIA E MJERIMEVE

*Kjo Litaní kendohet per çfaredó mjerím ne funt te Mbremesores, ose te Mengjezit.*

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe qe ta ruash keté qytét e keté vent nga murtaja, nga zia, nga thatesia, nga brésheri, nga termeti, nga permbytja, nga zjarri, nga shpata, nga invazja e huaj, nga lufta e brëndeshme, dhe nga çdo mjerím, qe na turet mi koke; dergona ere te buta, koha paqesore, dhe shira mirebérese, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

PRIFTI: Degjona, o Perendí, o Shpetimtari ync, shpresa e gjithë áncve te dheut edhe te atyre, qe lundrezojne ne detet e larkme; dhe hiresoji mekatat tona, o Kryezót, edhe meshirona.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót e njeridashes, edhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Paqe te gjítheve.

KORI: Dhe me frymen tende.

DHJAKU: Kreret tona Zotit le tja unjim.

*Pastáj Prifti thote me ze te larte:*

PRIFTI: O Kryezót, o Zoti ync Jesú Krisht, o Perendia ync meshireplót; me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve; prit-e lutjen tone me miresí; dhurona ndjesen e mekátave tona; mbulona nene hien e fléteve te tua; largó prej nesh te gjithë armiqtë dhe kundreshtaret; paqesona jeten; o Zot, kij meshire per né dhe per boten tende; dhe shpctoji shpirtet tona, si i mire dhe njeridashes.

KORI: Amín.

### URATA PER THEMELITG E NJG SHTEPIE

O Perendí i terefúqishim, qe themelove dhenc dhe krijove tere boten, shtjer syrin mi sherbetorin tent (*aksh*), qe po ngre keté shtepí, dhe shiguroje mi shkembim e patundur te Ungjillit tent; vleresoje ta mbaronje keté veper me faqe te bardhe, dhe rúaji nene hien tende te gjithë atá, qe kanë per te banuar ketú. Se jotja eshte Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA PER SHTEPING E RE

O Zot, o Perendia ync, qe dignove te hysh ne

shtepin' e Zakheut, edhe e shpctove até edhe tere familen e tij; ti, o Zot, eja dhe taní, dhe bekoje keté shtepí dhe gjithë banoret e saj; rúaji nene hien tende; mproji nga te gjithë reziket; dhe dhuroju te gjitha te mirat e dheut; me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve. Amín.

### URATA E FURRES

O Zot i terefuqishim, qe e ktheve flagen e furres se Babillones ne vese, dhe i rúajte te tre Dje-mat te pangare; ti, o Zot, bekoje keté furre pas meshires sate, dhe bekoje vepren e sherbetorit tent (*aksh*); mbaroje, dhe drejtoje pas miresise sate; me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve. Se ti i bekón dhe i shenjterón te gjitha, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E ANIES

O Zot, o Perendí i Aterve tane, qe e porrosite Noen ta ndërtonje Arken per shpetimin e njerzise; ti, o Kryezót i gjithesise, bekoje keté anie; jep-i nje Engjell udhheqes; rúaji até, qe kane per te lundrezuar ne keté; dhe vleresoji te kthehen shendoshe prane te dáshurve te tyre; me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve. Se ti e qeverís dhe e shenjterón gjithesine, o Perendia yne, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E RJETAVE

O Zot, o Perendia yne, qe nginje pese mije veta me pese buke dhe dy pishq; ti, o Kryezót i terefuqishim, bekoji ketó rjeta dhe até, qe do ti perdorin, dhe rúaji me paqe dhe shendét te shpirtit e te trupit; me nermjetimet e Shen Marise, te Apostullit Shen Pjeter dhe te gjithë Shenjtóreve. Se ti je dhurónjesi i gjithë te mírave, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA PER MIHJEN E PUSIT

O Zot, o Perendia yne, qe rodhe uje prej shkembit per pópullin tent; ti, o Kryezót i gjithesise, degjoje lutjen tone, dhe vleresona te gjejme ne keté vent uje te kulluar per te pire, dhe te mjafte per nevojat tona. Se ti je burimi i gjithë te mírave, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

### URATA E LCMIT

O Zot, o Perendia yne, qe urdherove dhene te na prodhonje peme per ushqimin tone; ti, o Kryezót i gjithesise, bekoje edhe keté leme, dhe shumoji pemet e sherbetóreve te tu; mbush-i hambaret e tyre me grure, me vere, me vaj dhe me gjithë te mirat e dheut; rúaji nene hien e fléteve te tua; ndrìçoji per te kupetuar porrosít' e tua; dhe vleresoji per te mirat e tua qellore. Se emri yt esht i

bekuar dhe i lavdëruar, i Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA PËR MBJELLJEN E VRESHTES

O Zoti ynë Jesú Krisht, ti je vreshta e vertetë, dhe Ati yt është bujku; ti i quajta Apostújt' e tu hardhí; ti e ngrite Israhelin nga Egjypta si një vreshtë, dhe e mbolle në Palestinë. Keshtú edhe taní, o Kryezót, bëj për këtë vreshtë: Eja, mbill-e, rrit-e, forcoje, rrethoje me garth, mproje nga dimri dhe nga shqota, nga brësheri dhe nga debora, nga çdo armik i dukur dhe i padukur; shtjer syrin, dhe veshetroje këtë vreshtë, që e ka mbjellur dora jote e djathtë, që të japë pemet e saj në kohën e duhur, dhe të vlerësohemi ta vjelim, dhe të të blatojmë verë për Kungatën e Krishtit. Se ty të ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA PËR VJELJEN E VRESHTES

O Perëndí, o Shpetimtari ynë, që e quajta vreshtë Birin e vetëmlindur, Zotin tonë Jesú Krisht, edhe e bërë verën burím të pavdekësisë me hirin e Shpirtit Shenjt; ti edhe taní, o Kryezót, bekoje pemën e kesáj vreshtë; shenjteroji të gjithë atá, që pjesëtojnë prej saj; dhe shërbëtorin tënt (*aksh*), i cili na ftoj këtë, bëj-e pjesëtár të vreshtes së vertetë, rúaje jetën e tij faqebardhë,

dhe stolis-e me dhuratat e tua të përjetme dhe të pavjethme. Me hirin dhe njeridashjen e Birit të vetëm, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin e tërëshenjta dhe të mirë dhe jeteberës, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA E RUSHIT

*Kjo Uratë këndohet me 6 të Gushtit.*

O Zot, bekoje pemën e re të vreshtes, që e ke arritur me erën e butë dhe me shin' e kulluar, që të na gezonjë, dhe të na i çpërblenjë mekatat, kur kungóhemi me Trupin edhe Gjakun e Zotit tonë Jesú Krisht, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin e tërëshenjta dhe të mirë dhe jeteberës, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA E VERËS

O Zot, o Perëndia ynë, shtjer syrin mi këtë verë, dhe bekoje, sikundër bekove liqenin e Silloamit edhe kupën e Apostujve të shenjta; ti, që u-ndodhe në Kaná të Galileës, dhe i bekove të gjashtë shtëmbat, edhe e ndryshove ujën me verë; ti, o Zot, edhe taní dergoje Shpirtin Shenjt mi këtë verë, dhe bekoje me emrin tënt. Se ti i bekón dhe i shenjterón të gjitha, o Krisht, o Perëndia ynë, dhe ty të dergojmë lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA E ARËS

*Kjo Uratë këndohet edhe për kopshtet.*

O Zot, o Perëndia ynë, që e stolisë dhënë me len-



dine, me bar e me lule; ti edhe taní, o Kryezót, shtjer syrin prej qellit mi keté arc (*a kopsht*), dhe bekoje; rúaje, dhe mproje nga çdo e keqe dhe çdo lengate; dhe vlerësoje të sjelle pemë plot me bekimet e tua në kohën e duhur. Se emri yt është i bekuar dhe i lavderuar, i Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

*Perpara se të thote këtë Uratë, Pifti e sperkát aren a kopshtin kryqthi me Ujë të Epifanise, ose me vaj nga kandilet e Shen Trifonit, Shen Stathit, ose Shen Julianit. Vajin nga këtë kandilë e merr Pifti pas Meshes.*

### URATA E FARCS

O Zot, o Perëndia ynë, që e ke urdheruar dhënë të rrite bima, dhe ti japë farë mbjëllesit edhe buke njeriut; ti, o Zot, bekoje këtë farë; largó prej saj çdo lengatë dhe çdo gjokë, që na heth për mekatat tona; dhe dërgó meshirat e tua të pásura mi tërë pópullin tënt. Me hirin dhe njeridashjen e Birit të vetem, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin e tëreshenjtes dhe të mirë dhe jetëberes, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA E PEMËVE TË DHURUARA

O Zot, o Perëndia ynë, që na urdherove të të blatojmë të tuat nga të tuat, edhe prite me kënaqesí dhuratën e varfer të gruas së vé; ti, o Kryezót, prit-i edhe taní pemet e blatúara prej sherbetorit tënt (*aksh*), dhe çpagúaji me thesaret e përjetme të qellit edhe me gezimin e të mirave të kesáj bote. Se emri yt është i bekuar dhe Mbretëria

jote e lavderuar, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA E GRIGJES

O Zot, o Perëndia ynë, që e regullón tërë krishten, të lútemi: Sikunder i bekove, dhe i shumove grigjat e Jakobit, ashtú bekoje edhe grigjen e bagetive të sherbetorit tënt (*aksh*), dhe shumojë, dhe forcoje, dhe rrit-e me míjera, dhe shpetojë nga tiraní e Djallit, nga lakmimi i të húajve, nga era vrásese dhe nga semundjet ngjítese. Rúaje me anën e Engjëjve të tu, dyke larguar prej saj çdo të keqe, çdo lengatë, çdo zilí dhe çdo veperím të Djallit. Se jotja është Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

### URATA E MISHRAVE

*Kjo Uratë këndohet ditën e Pashkes së Madhe.*

O Zoti ynë Jesú Krisht, o Perëndia ynë, shtjer syrin mi këtë mishra, dhe bekoji, sikunder e bekove shqerën, që të solli Abrahami besnik, edhe qengjin, që të dogji Abeli si therorë hollokoste, edhe viçin e ushqyer, që urdherove të theret për birin e arratisur, që u-kthye pranë teje; që të vlerësóhemi si aý ta gezojmë hirin tënt, edhe ti shijojmë gjellet e bekúara prej teje për ushqimin e të gjítheve. Se ti je ushqimi i vertetë dhe dhurónjesi i të mirave, dhe ty të dergojmë lavdí, bashkë me Atin e panismë dhe me Shpirtin e tërë-

shenjtc dhe tc mire dhe jeteberes, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

#### URATA E DJATHES EDHE VEZEVE

O Zot, o Perendia ync, bekoje keté djathe dhe ketó veze, shumoji per atá, qe i blatojne a pjesetojne, dhe vleresona per dhuratat e tua qellore tc pambarúara. Se jotja eshte Mbretcria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

#### URATA E KRIPES

O Zot, o Perendia ync, qe vajte ne Jerikó, dhe me kripc i shcrove újerat e démshime; ti, o Kryezót, bekoje edhe keté kripc, dhe bej-e therore ngazellimi. Se ti je Perendia ync, dhe ty tc dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

#### URATA PERPARA SE NGRENES

O Zoti Jesú Krisht, bekoji tc ngrcnat e tc pirat e sherbetóreve tc tu, gjithenjc, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

#### URATA PAS SE NGRENES

Te lavderojme, o Zot, qe na gezove me tc ngrcna e me tc pira, gjithenjc, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

#### URATA PERPARA GJUMIT

O Zoti Jesú Krisht, mbulome nene hien e fléteve tc tua, qe tc fle me paqe, dhe tc ngrihem

shendoshc, dhe ta lavderónj Trinín' e Shenjte, gjithenjc, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

#### URATA E MENGJELIT

O Zoti Jesú Krisht, qe me ngrite nga gjumi, ndritma mendjen, edhe celmi buzct, qe ta lavderónj Trinín' e Shenjte, gjithenjc, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.